



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 590 prot.

Tepelenë, më 25.03.2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. GRAMOS SAKO

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e hënë më datë 30.03.2026, ora 11:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 26.02.2026.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shkurt 2026."
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shkurt 2026".
5. **Projektvendim:** "Për miratimin e parshikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavaneve përgatitore të PBA 2027- 2029."
6. **Projektvendim:** "Për miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Tepelenë në programin për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë."
7. **Projektvendim:** "Për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim, në favor të qendrës "ACEG", një pjesë të objektit publik Shkolla 9-vjeçare "Asim Zeneli", fshatin Progonat, Bashkia Tepelenë, si dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim."

8. **Projektvendim:** “Për miratimin e marrëveshjes tip me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.”
9. **Projektvendim:** “Për vendosjen e eshtrave të Dëshmorit të Atdheut, Mirjan Dino Hoxha, në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut të Tepelenës.”
10. **Projektvendim:** “Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Tepelenë.”
11. Çështje të tjera.
12. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

ARBEN GUMENI

